

Kontratat Kolektive të Punës

Një pasqyrë e përgjithshme

2

Ish ylli Romaio dhe botërori 2014

«Plaçkitja më e madhe historike!»

3

Zgjedhjet parlamentare në Kosovë

Mërgata anashkalohet përsëri!

4

Nr. 4 | korrik 2014 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Barazia e pagave

Barazia në paga po ecën shumë ngadalë

Dialogu i barazisë në paga (Logib), i cili u mundësonte ndërmarrjeve, që vullnetarisht të kontrollonin sistemin e pagave në raport me diskriminimin gjinor, do të ishte një hap në drejtimin e duhur. Mirëpo eksperimenti «Logib» dështoi për shkak të pjesëmarrjes së pamjaftueshme të ndërmarrjeve. «Logib» edhe ka treguar se: pa masa të obligueshme sa i përket barazisë në paga do të ecim edhe më tej me shpejtësinë e kërmillit. Andaj ne kërkojmë barazinë e pagave tani – nevojiten kontrollet!

Në Kongresin e Grave të Unionit të Sindikatave të Zvicrës (USZ) në vitin 2013 anëtarja e qeverisë federale Samaruaga u detyrua të pranonte se: dialogu përkitazi me barazinë në paga ka dështuar. Ajo pos tjerash erdhi në përfundim se: Nëse ekonomia nuk ia arrin vet, atëherë duhet të ndihmojë politika. Si duket është faks se vet ekonomia nuk do t'ia arrin. Dallimi në paga nuk është duke u zvogëluar, bile edhe është duke u rritur! Dallimi në paga mes burrave dhe grave është rritur nga 18,4 në 18,9%. Sa më e lartë pozita e gruas edhe dallimi në paga me kolegët e saj burra është më i lartë.

Tani duhet ndërmarr masa!

Kjo situatë ka alarmuar gratë e USZ-së për të ardhur në përfundim se



Pamje nga njëri prej aksioneve të sivjetmë për barazinë e menjëhershme të pagave për gratë

tani duhet vepruar dhe se koha e masave vullnetare ka kaluar! Më 2 qershor gratë e USZ-së në kuadër të 14 qershorit përmes aksioneve të shumanshme i ka dorëzuar qeverisë federale një letër të hapur publike, në të cilën kanë shtruar kërkesat e tyre.

Kontrolle të rregullta dhe sanksione

Katalogu i USZ-së me masat që duhet ndërmarrë, parasheh që ndërmarrjet të kontrollojnë rregullisht ashtu si parasheh edhe ligji (p.sh. çdo tri vjet). Ndërmarrjet pos tjerash du-

het të ofrojnë transparencë të plotë interne mbi pagat. Për të realizuar në mënyrë efektive si dhe për të kontrolluar e siguruar në mënyrë konsekuente barazinë në paga, pos tjerash nevojitet edhe një ent nacional, ngjashëm me komisionin e paritetit. Ai duhet të jetë kompetent, të realizoj këto kontrolle edhe me detyrë zyrtare dhe të ndërmer masat e nevojshme drejt realizimit të barazisë në paga, qoftë përmes ngritjen e padive, dënimeve apo vendimeve. Në rast të diskriminimit të dëshmuar vlen toleranca zero.

Shënojeni 7 marsin 2015

Presioni karshi qeverisë federale do të mbahet gjallë edhe në rrugë. Andaj 7 marsi është data, të cilën ne duhet ta mbajmë mend. Gratë sindikaliste bashkë me organizatat tjera të grave kanë vendosur që më 7 mars 2015 të organizojnë një demonstratë kombëtare, për ti dhënë peshë kërkesave të tyre! Pas 33 vjetësh të aprovimit të nenit kushtetues për barazi dhe 18 vjet të ligjit për barazi është koha e fundit që barazia në paga të vij tani dhe jo tek pas 70 vjetësh!

⇒ Aurora Garcia



Nënat me fëmijë në aksion



Pamje nga aksioni tjetër



Gratë protestuan gjithandej

Rregulla te reja për dhënie gjiri

Që nga 1 qershori gratë kanë të drejtë që në vitin e parë të jetës së fëmijës së tyre për pauzë dhënie gjiri të paguar në vendin e punës. Paguesa bëhet bazuar në orarin e përditshëm të punës: deri në 4 orë orar punë në ditë ekziston e drejta për dhënie gjiri prej gjithsejtë 30 minutash, në mbi 4 orë janë 60 minuta dhe mbi 7 orë 90 minuta. Këto rregulla vlejën edhe për pompim e qumështit të gjirit. Fëmijës mund ti epet gjë edhe jashtë vendit të punës.

Fëmija i sëmurë? Çka vlen?

Në rast të sëmundjes së fëmijës dhe nevojës për kurim, prindërit kanë të drejtë në tri ditë pushimi për çdo rast sëmundjeje (dhe jo për një vit). Babai apo nëna në një rast të tillë ka të drejtë në pagesën e mëtejme të pagës, me kusht që marrëdhënia e punës ka vlefshmëri tre mujore dhe se ajo është paraparë të vazhdohet edhe për tre muaj tjerë. Vazhdimi i pagesës së pagës për prindër është e kufizuar. Kjo përcaktohet në bazë të vendit të punës dhe në bazë të rregullave tjera – interesohuni se cilat rregulla vlejën në rastin Tuaj.

Editorial



4000 Frangat janë përcaktuar

Rezultati i votimeve mbi pagën minimale paraqet një zhgënjim të ithët për të gjithë sindikalistet e sindikalistet. Ky është një shenjë negative për të ardhmen e Zvicrës. Pasi që me të ardhurat e tyre të gjithë njerëzit që jetojnë e punojnë në Zvicër duhet të mund të jetojnë. Prandaj janë të nevojshme pagat korrekte. Kjo në betejën votuese nuk është kundërshtuar nga asnjë punëdhënës apo politikan e politikane. Megjithatë bash për këtë ia ka vlejtur beteja votuese. Ne kemi humbur votimin, mirëpo në botën e punës ne kemi arritur shumë suksese. 4000 Franga si pagë korrekte ka arritur pranueshmëri të përgjithshme. Shumë punëdhënës nga shumë sektorë ekonomik në muajt e fundit për shkak të iniciativës sonë janë detyruar të rrisin pagat e tyre në 4000 Franga. Shembull për këtë janë H&M, Bata apo Aldi. 4000 Franga vlejën edhe për luleshitëset dhe personelin shitës tek bukëpjekësit si dhe tek tregtimi me pakicë në Gjenevë (KKP me Unia-n). Edhe në kopshtari paga minimale prej 4000 Frangave është realizuar pjesërisht dhe në këtë drejtim të 4000 Frangave është duke shkuar edhe industria e orëve dhe sektori i industrisë së shtypshkronjave dhe grafikëve. Që nga koha kur sindikatat para 18 viteve kanë kritikuar pagat e ulëta në Zvicrën e pasur dhe kanë kërkuar paga korrekte, pagat janë rritur në vazhdimësi, shembulli bie në gastronomi deri në rreth 1000 Franga në muaj. Ne pra edhe deri më tani kemi shënuar shumë të arritura dhe në bisedimet për paga dhe Kontrata Kolektive të Punës bashkë me anëtarët aktiv të Unia-s do të luftojmë me këmbëngulësi.

Corinne Schärer

Anëtare e drejtorisë qendrore në Unia

News

Ratifikohet konventa për të punësuarit në amvisni

Parlamenti i Zvicrës më 12 qershor ka aprovuar ratifikimin e (ILO)-Marrëveshjes së Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Kjo Marrëveshje që ka për qëllim të fuqizojë pozitën e të punësuarve në amvisnit shtëpiake, të cilët shpesh shfrytëzohen brutalisht, do të vlejë edhe në Zvicër. Të punësuarit shtëpiaq i takojnë grupit nga më të shfrytëzuar të të punësuarve. Në disa shtete të drejtat e tyre shkelen me të dyja këmbët. Andaj posaçërisht këta janë të varur nga mbrojtja ligjore. Marrëveshja e ILO-s 189 ankron standardet minimale që vlejné në të gjithë botën.

Paga minimale në kantonin e Neuenburg-ut

Këshilli kantonal i Neuenburg-ut në fund të muajit maj ka aprovuar një ligj të ri. Ai definon pagën minimale të këtij Kantoni dhe zbatimin e tij. Paga minimale në Neuenburg është rezultat i bisedimeve të gjata mes partnerëve social. Tanimë Neuenburg-u ka përcaktuar pagën minimale prej 3640 Frangave (x12) tek 42 orë punën në javë, d.m.th. 20.-Franga në orë. Fuqizimi i këtij kufiri të pagës më të ulët ka të bëjë me 4 % të të punësuarve në Kanton dhe kështu paraqet për 2700 punëtorë rritje të pagave.

Zgjatje e orarit të punës së shitoreve? Jo!



Sindikata Unia refuzon zyrtarisht propozimin për një ligj të ri federal mbi orarin e punës së shitoreve. Ligji i ri do të qonte tek orari i punës së shitoreve nga ora 6 deri në ora 20 gjatë ditëve të javës deh të shtunave nga ora 6 deri në ora 19. Sindikata Unia dënon këtë sulm karshi kushteve të punës për personelin shitës, që bie në kundërshtim edhe me vullnetin e popullit. Pasi që në tregtimin me pakicë nuk ekziston KKP e plotfuqishme, zgjatja e orarit të punës qon tek fleksibiliteti i kushteve të punës dhe tek orari i stërzgatur i punës mbrëmjeve dhe në fundjavë dhe e tërë kjo pa kompensim.

Bisedimet Kontratave Kolektive të Punës

Peticion për të punësuarit pa status të rregulluar në amvisni

Në muajt e fundit janë përmbyllur një numër i mirë i Kontratave Kolektive të Punës (KKP), ndërsa disa të tjera me rëndësi do të përfundojnë në muajt e ardhshëm. Në vijim lexuesve tanë të Horizontit ne do tua japim një pasqyrë mbi KKP-të e përmbyllura dhe atyre që janë pritur të përfundimit.

Qysh në numrin e kaluar ne kemi paralajmëruar se sektori i përkujdesjes private për pleqtë në Zvicrën gjermane është bërë me KKP të re, të cilën tanimë edhe zyrtarisht e kanë nënshkruar partnerët gjegjësisht kontraktues. Një moment historik ky për një sektor, i cili është në rritje e sipër dhe në të cilin mbrojtja e kushteve të punës është posaçërisht e rëndësishme. Qëllimi është që KKP-ja deri më së largu në vitin 2015 të shpallet e plotfuqishme.

Belimed-Sauter: KKP me karakter shembullor

Se ia vlen që partneriteti social të merret seriozisht, tregon shumë mirë edhe shembulli i KKP-së së re të firmës Belimed Sauter, e cila vepron në sektorin e sterilizimit dhe e cila punëson rreth 300 veta. KKP-ja e re tanimë është fuqizuar dhe vlen deri në vitin 2019. Rishtas në kuadër të KKP-së përshihen edhe punonjësit temporal dhe shegertët. Posaçërisht e



Pamje nga shitoret në pikat e karburanteve, tanimë të pajisura me KKP-nacionale

kënaqshme është gjithashtu paga minimale për të pakualifikuarit dhe për të kualifikuarit si dhe transparenca e përcaktuese e pagave dhe pushimeve. Pos tjerash edhe sa i përket barazisë ka lëvizje pozitive; janë përcaktuar disa rregulla mbi temën barazia në paga dhe është zgjeruar pushimi për nëna dhe etër në rast të lindjes së fëmijës. Nga pikëpamja sindikaliste gjithashtu e kënaqshme është zgjerimi i të drejtave të punëmarrësve, shembulli bie mbrojtja e pushimit nga puna për anëtarët e komisionit të personelit.

Puna në pikat e karburanteve: KKP nacionale

Kësaj pranvere shoqata e pikave të karburanteve të Zvicrës (VTSS), shoqata tregtare e Zvicrës dhe sindikatat Unia e Syna kanë filluar bisedimet e përbashkëta në rrafshin kombëtar

për një KKP për të punësuarit nëpër shitoret e pikave të karburanteve. Një hap ky me rëndësi kur dihet se në këto shitore punojnë rreth 14 200 punonjës. Për këtë sektor deri më tani kemi një KKP të plotfuqishme vetëm në kantonet Freiburg, St. Gallen dhe Luzern. Është planifikuar që KKP-ja e re të hyj në fuqi nga viti 2016. Kontrata duhet të jetë e plotfuqishme.

Kontrata e përgjithshme vendore dhe pastrimi në Zvicrën gjermane

Edhe KKP-ja e sektorit të pastrimit në Zvicrën gjermane, e cila vlen për rreth 40000 punëmarrës të firmave të pastrimit, do të negociohet rishtas. Këtu tema me rëndësi është rritja e pagave.

Edhe Kontratës së përgjithshme vendore (LMV), njëres nga KKP-të në të

rëndësishme të Zvicrës, e cila rregullon kushtet e punës për 80000 punonjës ndërtimtarie, i kalon afati në fund të vitit të ardhshëm. Përgatitjet për ripërtëritjen janë duke u zhvilluar me shpejtësi të plotë. Ndërtimtaria i ka punët shumë mirë dhe megjithatë pronarët e firmave refuzojnë rritjen korrekte të pagave. Në mbledhjen vendore të ndërtimtarëve të Unia-s më 28 qershor nga të pranishmit po kërkohet rritje e pagave dhe do të përcaktohen edhe kërkesat kryesore për ripërtëritjen e marrëveshjes. Për vitin e ardhshëm priten mobilizime të mëdha. Për një Kontratë të Përgjithshme Vendore nevojitet mbështetja e secilit!

© Aurora Garcia



Nevojitet rritje e pagave

Sektori i pastrimit

Valorizimi i aftësive – një qasje e re për sektorin e pastrimit



Projekti evropian Valbuk (www.valbuk.ch), i cili është startuar në vitin 2012 nga fondacioni ECAP, ka vu si qëllim kualifikimin e punëmarrësve nga sektori i pastrimit. Konkretisht projekti dëshiron tu mundësojë kualifikimin të varurve nga paga mbështetur në matricën e kompetencave, në bazë të së cilës zhvillohet procedura modulare e kualifikimit. Këto qëllime duhet të mundësojnë që të njihen e pranohen mësimet formale dhe ato joformale. Grupi i projektit është aktiv në Zvicër, Francë, Austri, Itali, Holandë, Gjermani dhe Sloveni.



Pagesa të bëhet në përputhje me aftësitë dhe kompetencat e punonjësve!

Dy probleme janë evidente në sektorin e pastrimit. Nga ana e punëmarrësve mund të vihet në përfundim, që punëmarrësit shpesh janë pak të kualifikuar, e qe punojnë me përqindje të pjesshme, kanë sfond migracioni dhe kanë fare pak ctyje për tu arsimuar më tej. Nga ana e punëdhënësve mund të vihet në përfundim që sektori është mjaft i koncentruar, se konkurrenca mes firmave është enorme dhe se arsimimi dhe aftësimi i mëtejme për ta jo gjithmonë paraqet prioritet.

Të modularizohet aftësimi i mëtejme

Grupi evropian i projektit nën drejtimin e fondacionit ECAP propozon matricën e aftësive, e cila mund të merret përsipër dhe të zhvillohet më tej nga sektori i pastrimit, respektivisht nga partnerët social. Matrica e aftësive është e ndër në 12 fusha kompetencash (shembulli bie, pastrimi në hapësirat e sterilizuara) dhe shpjegon nëcilin kontekst duhet kryer puna (p.sh. në zyre) dhe parashih shumë nivele shkalësh (drejtues ekipi, etj.). Matrica është një mjet pune, i cili mund të përdoret në kuadër të aftësimit të mëtejme, parashih një modul dhe me këtë edhe një proces të përshtatshëm të arsimimit të mëtejme. Një libër udhëzues dhe udhërrëfyes

duhet pos tjerash të mundësoi, që e mësuara (gjegjësisht në rast të posedimit të arsimimit të njohur) në një kontekst formal të kombinohet me të mësuarin informate (gjegjësisht tek puna) dhe kështu të njihet dhe pranohet si e tillë.

Rrugë të reja të arsimimit të mëtejme

Një nga qëllimet e projektit Valbuku, i cili realizohet në kuadër të programit evropian «Mësim i përjetshëm» është ndryshimi i imazhit të një sektori, i cili nga punëdhënësit vlerësohet pak dhe për punëmarrësit është pak atraktiv. Projekti propozon një rrugë të re, e cila është afatgjate dhe e përshtatshme për të varurit nga paga.

© Dr Bénédicte Halba, Irv/Francë

Më shumë Informata në: www.valbuk.ch et http://valbuk-france.blogspot.fr/



Burgji i pagave, falimentimi dhe paaftësia e kompensimit të pagave

Punëdhënësi nuk paguan: Si duhet të veproj?

Martini punon ka 20 vite tek e njëjtë firma moleri dhe deri para disa muajve ka marr në kohë të saktë pagën e tij. Mirëpo që nga janari ai merr gjithmonë me vonesë pagën e tij. Tani është fillimi i korrikut dhe ai ende nuk ka marrë pagën e muajve maj dhe qershor. Çka mund të bëjë ai? A mund të prish marrëdhënien e punës menjëherë? Çka ndodh me pagën e tij, në se firma falimenton?



Hapi i parë: vërejtje me shkrim

Sipas ligjit paga duhet më së voni të arrijë në konton e punëmarrësit në ditën e fundit të muajit. Nëse Martini nuk e ka marr pagën e dy muajve të fundit, atëherë ai duhet menjëherë të veproj: Ai duhet t'ia tërheqë vërejtjen punëdhënësit të tij, për shkaqe faktike me shkrim dhe me postë rekomande. Ai duhet ti jep firmës një afat të shkurtër (1 javësh) për të bërë pagesën e munguar. Nëse firma paraprakisht nuk është në gjendje të paguajë, atëherë Martini duhet të kërkoj që ajo që të siguroi garanci për pagat e ardhshme (garanci bankare, deponim i letrave me vlerë). Vet Martini ka të drejtë të ndërprësë punën deri në momentin që punëdhënësi bënë pagesën e pagës së munguar. Mirëpo kujdes. Nëse firma gjendet në falimentim, Martini mund të merr vetëm pagesën për punën e kryer, çka d.m.th. se për ditë të që ka ndërprerë punën nuk merr kompensim fare.

Lajmërim i menjëhershëm tek RAV

Nëse Martini për shkak të rrezikimit të marrjes së pagës prish marrëdhënien e punës, ai duhet të lajmërohet menjëherë tek Enti Regjional për Punësim (RAV) dhe të paraqet kërkesën për kompensimin pranë Arkës së Sigurimit të Papunësisë. Nga dita e lajmërimit ati i takojnë parat ditore, nëse ai i plotëson parakushtet në lidhje me kompensimin e papunësisë.

Martini ka paraqitë rastin në entin kompetent, mirëpo firma ka falimentuar. Çka tani?

Martini duhet të dorëzoj kërkesën për pagat e munguara tek enti për falimentim dhe të shtrjojë kërkesën për kompensim të pagave të munguara tek Arka e të Papunëve të Kantont. Kujdes: Martini duhet të ketë

parasysh se kompensimi për pagat e munguara mund të bëhet i vlefshëm vetëm brenda 60 ditëve nga paraqitja e falimentimit. Pas këtij afati bëhet vonë pakthyeshmë.

Çka mbulon kompensimi i paaftësisë paguese?

Kompensimi i pagave të munguara mbulon kërkesat për paga të muajve të fundit të marrëdhënieve të punës. Në parim kompensimi i paaftësisë paguese mbulon 100% të pagës mujore bruto (maksimalisht 10500 Franga në muaj). Kontributet ligjore të sigurimeve shoqërore hiqen. Nuk mbulohen me këtë rast shtesat e fëmijëve, harxhimet e rrugës si dhe parat në rast sëmundjeje dhe aksidenti. Këto duhet të dëshmojnë si të vlefshme tek Arka gjegjëse e kompensimit, gjegjësisht tek sigurimi shëndetësor dhe ai aksidental. Në broshurën «Kompensimi i paaftësisë paguese» të SECO (Sekretariatit Shtetëror për Ekonomi) mund të gjinden të gjitha informatat e rëndësishme mbi «Kompensimin e paaftësisë paguese». Kjo broshurë në gjuhën gjermane, frënge apo italiane, mund të shkarkohet nga <http://www.treffpunkt-arbeit.ch/publikationen/broschueren/>

© Montaña Martín

Iniciativa popullore zvicerane Ecopop

Jo për Ecopop!

Në sesionin e sivjetmë vor Parlamentin zviceran ka refuzuar qartas iniciativën Ecopop. Ajo megjithatë parashihet të hidhet në votim popullor në fund të nëntorit të këtij viti. Edhe pse iniciativa është refuzuar nga Parlamenti, ajo megjithatë është e rrezikshme. Ne na duhet përsëri të përballemi me një iniciativë, e cila migrantët i paraqet si faktorë kujdestar dhe të vetëm për problemet metën cilat përballtet Zvicra dhe e cila iniciativë atakon të drejtat e punëmarrësve.

zhvillim-bashkëpunim me vendet e varfra të shkojnë për «planifikimin vullnetar familjar».

Përsë Unia i thotë JO Ecopop-it

Iniciativa Ecopop synon që problemet mjedisore ti «zgjidh» përmes kufizimit radikal të emigracionit, respektivisht rritjes së popullsisë. Kështu ajo migrantët i bënë faktorë kujdestarë për problemet mjedisore dhe ctytë diskriminimin e njerëzve që nuk posedojnë pasaportë zvicerane. Edhe nëse përfaqësuesit e saj provojnë të kundërshtojnë këtë, ata megjithatë bëhen bashkëfajtor me partitë dhe rrymave të djathta populiste, të cilat ka vite që predikojnë: Migracioni është i dëmshëm, andaj Zvicra do të duhej që ta «kontrollojë» më fortë dhe të lejojë hyrjen në vend vetëm atyre, të cilët janë të «dobishëm».


Ecopop është atak kundër punëmarrësve

Unia i thotë posaçërisht Jo Ecopop-it, pasi që ajo qon në përkeqësimin e kushteve të jetës dhe të punës për

të gjithë, pasi punëdhënësit për shkak të kufizimit të emigracionit do të anojnë drejtë lejeve të shkurtra të qëndrimit. Iniciativa në fund të fundit nuk zgjidh asnjë problem mjedisor, pasi problemi kryesor për krizat mjedisore nuk janë njerëzit «e shumtë», por që disa nga ta jetojnë përtej mundësive të tyre dhe konsumojnë bagaji shumë burime. Iniciativa pos tjerash është kolonialiste, pasi ajo kthehet mbrapsht në paradigmen e vjetër të kontrollimit të popullatës. Ajo obligon Zvicrën që tu predikojë vendeve të varfra heqjen dorë nga fëmijët. Kërkesa e njëanshme për «planifikim vullnetar familjar», ashtu si kërkon iniciativa Ecopop, është mjet i gabuar për të luftuar varfërinë. Norma e lartë e lindjeve është pasojë, e jo shkak i varfërisë. Të gjitha përvojat tregojnë: Sa më mirë që të jetojë njeriu, sa më të larta të jenë të ardhurat dha sa më mirë të jetë pozita e graus në shoqëri, aq më i ulët është niveli i lindjeve. Këtu është e nevojshme për tu përqendruar.

© Aurora Garcia

Portret



Ish ylli i futbollit, tani politikan i majtë Romario

«Plaçkitja më e madhe historike!»

Si yll futbollit Romario ndihmoi që Kampionati Botëror të zhvillohet në Brazil. Si politikan i majtë, ai sot është kritikuesi më i ashpër i tij.

Ish- futbollisti botëror Romario nuk mund të fshehë zhgënjimin e tij: «Ne do të mund të bënim një botëror ndër më të mirët e të gjitha kohërave». Mirëpo pastaj erdhën armiqte e futbollit dhe shkatërruan gjithçka, deklaroi ai karshi televizionit sportiv ESPN Brazil. Armiqte e futbollit, këta për ish yllin sulmues Romario janë njerëzit si kryetari i Fifa-s Sepp Blatter («një hajni i korruptuar»), apo sekretari gjeneral i Fifa-s, Jérôme Valcke («një shantazhist»). Ata, shoqata botërore e futbollit dhe sponsorët e saj, janë të interesuar vetëm për të përfituar para. Ata nuk qajnë kokën, çka lënë pas në Brazil: «Ky botëror futbollit është plaçkitja më e madhe në historinë tonë». Fifa heshtë në lidhje me këto akuza. I fjalët e Roamrios kanë peshë në Brazil. Ai është një hero futbollit, yll i ekipit të botërorit 1994. Me pesë gola të shënuara atëherë në SHBA fitoi për Selecao titullin dhe hyri kështu në zemrat e tifozëve. Njeriut të gjatë vetëm 1,69 metra i brohoritnin «O Baixinho» («i shkurtër»). Sot «O Baixinho» merret me politik. Ai është anëtar i Kongresit nga radhët e socialistëve, të cilët me një ministër marrin pjesë në qeveririn e majtë të Dilma Rousseff-it. Romario thekson: «Unë kam ngjyrë të mbyllur lëkurë dhe vij nga Favales. E di, çka domethënë, me qenë i varfër...» Andaj ai është socialist.

18 miliarda për botërorin

Romario është rritur në pjesën e varfër të Jacarezinho në Rio. Aty në çdo kilometër katror jetojnë 60000 njerëz. Politikani Romario përshkruan kushtet jetësore kështu: «Ne kemi spitale pa shtretër, në të cilat njerëzit flenë nëpër tokë. Ne kemi shkolla, në të cilat fëmijët nuk marrin shujta.» Pra investimet janë urgjentisht të nevojshme. Mirëpo, në vend se në Favelas, paratë shkojnë në lagjet e brendshme të qyteteve. Nga kjo përfitojnë luajt e ndërtimit, politikanët e blerë, funksionarët sportiv dhe sponsorët. Prandaj Roamrio flet nga shpirti i shumë njerëzve, kur thotë: «Do të ishte më mirë sikur paratë e futbollit botëror ti investonim në arsimim dhe shëndetësi». Kupa e futbollit botëror në Brazil vlerësohet se mund të shkojë në 18 miliardë Franga.

«Suksesi im më i madh»

Romario do të kishte mundësi të pushonte në shumë miliona dollarë të karrierës së tij të futbollit profesional, e cila atë do ta qonte atë përmes PVS Eindhoven deri tek Barcelona. Mirëpo ndërruesi i karrierës punën e tij prej politikan e merr seriozisht. Për vetëm 6 muaj ai në kryeqytetin Brazilia ka arritur të përvojtojë një ligj, i cili njerëzve me aftësi të kufizuara u mundëson marrjen e pensionit të invaliditetit. Ky është një sukses i madh, thotë ai: «Shënimi i një goli nuk krahasohet me këtë të arritur. Me këtë unë më të vërtet kam arritur diçka.» Edhe për shkak të vajzës së tij Ivy, Romario lufton për të drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuara. Ivy është fëmija i gjashtë i Roamrios i lindur –me Sindromin Down – në vitin 2005. Për shejtanin e atëherëshim qoi ishte e papararenduar: «Unë pyetja veten se çfarë gabimi kam bërë. Përsë më ndodh bash mua?». Super ylli grindej me fatin e tij. Po pastaj, një muaj më vonë, kishte një prezantim lamtumirës për kombëtaren braziliane (kundër Guatemales). Ai bëri atë që ishte më së miri dhe shënoi 2:0. Me rastin e ngazëllimit shënues të golit të dytë ai shpalosi fanellën e tij. Në të me germa të mëdha qendronte: «Vajza ime është një princesh.» Ivy ka ndryshuar ish yllin e futbollit. Romario i sotshëm thotë për Romairon e mëhershëm: «Unë isha një Egomania...». «Lapa ime e madhe» Tërë kjo na ishte njëherë. Apo edhe jo? Edhe më tej plejboji «Baixinho» i donë partitë dhe Luksin. Ferrarin e tij të kuq. Pushimoren e tij direkt në plazhin e Rios. Vilën e tij në Brasilia. Ndodh që edhe më tej ai të luan mendsh. Çka kanë të përbashkët Romario sulmuesi dhe Romario politikanin i majtë? «Në të dy jemi llaflazanë».

© Nga Marco Gelschbühler, Nr. 10 work, 6.6.2014

Mërgimtarët kërkuar që tu mundësohet votimi për zgjedhjet e përgjithshme

Zgjedhjet në Kosovë të zhvillohen me 3 gusht 2014

3 gushti 2014 do të ishte data më e preferuar për shumicën e mërgimtarëve tanë nga Zvicra, Gjermania dhe shtetet tjera Evropiane, pasi që kjo datë i bie në kohën kur në të gjitha këto vende edhe zyrtarisht janë pushimet verore shkollore, ndërsa shumica e mërgimtarëve tanë pushimet e verës i kalojnë kryesisht në vendlindje.

Mërgata jonë në të gjitha periudhat kohore ka dhënë një kontribut për shoqërinë dhe vendin amë. Kryesisht që nga viti 1981 e këtej edhe si ambasadore (zëngritëse e zëdhënëse) e kërkesave dhe luftës së drejtë të popullit tonë gjithandëj. Mërgimtarët tanë, përpos që kanë kontribuar pandarë për të siguruar ekzistencën e familjeve dhe popullit në atdhe, jo rrallë dhe jo pak kanë kontribuar edhe në të gjitha fushat mundshme jetësore, si arsimore, shëndetësore, informative, si dhe në jetën e gjithmbarshme strukturore e infrastrukturore në vendlindje e atdhe. Është po kjo mërgatë që për më shumë se 10 vite mbështeti materialisht dhe profesionalisht institucionet paralele në kohën e aparteidit të shtetit të Serbisë në Kosovë dhe njëkohësisht që nga zanafilla, edhe përpjekjet e veprimet e para të përgatitjeve për luftë të armatosur çlirimtare. Mërgata në mënyrën më të ndërgjegjshme dhe të pakursyer mbështeti luftën çlirimtare si financiarisht, ashtu edhe me logjistikë dhe njerëz. Menjëherë pasluftës, po kjo mërgatë, me paranë e djersës së vet rindërtoi shtëpitë e shumta dhe vendin e shkatërruar nga lufta dhe përsëri mbajti gjallë njerëzit jo vetëm të familjeve dhe farefisit të vet në atdhe, por edhe nevojtarët e pastrehë, të sëmurit e shumëçka tjetër. Pra mërgimtarët kanë kryer të gjitha obligimet e tyre të mundshme njerëzore, qytetare, shoqërore e kombëtare.

Nga 800 000 mërgimtar votuan vetëm 1500

Fakti se, sipas të dhënave zyrtare, në zgjedhjet komunale të vendit në vitin të kaluar kanë votuar gjithsejtë rreth 1500 qytetarë të Republikës së Kosovës jashtë vendit, arsyeve dhe fuqizon këtë kërkesë dhe nevojë të drejtë dhe potenciale për vendin dhe shoqërinë. Kështu mërgimtarëve të shumtë për herë të parë në historinë e shtetit të tyre, për të cilin kanë merita të veçanta, do të duhej tu mundësohet pjesëmarrja edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes votës së tyre në vendvotimet e vendlindjes së tyre, me çka diaspora e Kosovës e përbërë prej 700 mijë deri 1 milion njerëz, do të filloj të bëhet pjesë aktive jo vetëm në proceset zgjedhore në Kosovë.



Pamje nga procesi votues, i cili zakonisht përcillet me parregullsi të shumta



Athua a do të respektohet vota?!

Mërgata pa vende të rezervuara

Është koha e fundit që ti jepet fund anashkalimit të diasporës dhe që institucionet përgjegjëse, KQZ-ja dhe Parlamenti i Republikës së Kosovës, përpos kërimit të kryerjes së obligimeve nga mërgata, tua mundësojnë mërgimtarëve, në këtë rast qytetarë të Republikës së Kosovës, të realizojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe të drejtën e tyre elementare qytetare të garantuar edhe me Kushtetutë. Edhe përkundër mungesës të mëtejme për të pas vende të parapara apo të rezervuara për mërgatën në Kuvend, bile tu mundësohet realizimi i të drejtës së votës në këto zgjedhje të përgjithshme për parlamentin e ardhshëm të Republikës së Kosovës.

E drejta e votës dhe zgjedhjes – e drejtë elementare njerëzore

Për të realizuar të drejtën e tyre njerëzore dhe qytetare të garantuar edhe me kushtetutën vendit, një grup mërgimtarësh, pjesëmarrës të seminarit më 16 mars 2014 për aktivistët sindikal shqiptar në kuadër të sindikatës Unia të Zvicrës, e cila ka afër 20000 anëtarë me prejardhje shqiptare, morën vendim njëzëri që publikisht të kërkojnë nga institucionet përgjegjëse dhe parlamenti i Republikës së Kosovës, që si datë të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të caktojnë 3 gushtin 2014. Gjithashtu

kërkohej krijimi i mundësive të votimit në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës si dhe përmes postës elektronike, pa përjashtuar edhe mundësitë tjera. Kjo kërkesë si e tillë mbështetet edhe nga dhjetëra shoqata të ndryshme të bashkatdhetarëve të mërgatës shqiptare.

Osman Osmani

Mbështetësit:

(sipas radhës së konfirmimit)

Aktivistët shqiptar të sindikatës Unia; Shkolla Shqiptare e Vallëzimit **Shota** në Zvicër; Shoqata **Parandalo** në Zvicër; Lidhja Shqiptare në Botë me qendër në Zvicër; Qendra profesionale për migracion **Prointegra**; Shoqata Shqiptare e Gruas **Drita** Cyrih; Bashkësia Shqiptare Shafhausen **Agsh/Bshsh**; Institucioni **ABSM** Bazel; Shoqëria Kulturo-Artistike **Dardania** Winterthur; Ansambli **Arbëresha** Sirmach; Grupi i Vallëzimit **Rinia** Spreitenbach; Qendra e integritimit kulturor **A. Moisiu** Zvicër; Shoqata **Glatt-Alb** Opfikon-Glattbrugg; Shoqata **ILIRIA** Leimen Gjermani; Shoqata **Nëna Terezë** – Heidelberg Gjermani; Shoqata **Arberia** Weischloch; Unioni Artistik për Mërgatë – Tiranë (ku aderojnë rreth 30 shoqata nga mërgata).

Fjalimi i deputetit Faton Topalli në seancën parlamentare për Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Prishtinë, 03 Prill 2014 – e Enjte

I nderuar Kryesues, të nderuara deputete dhe deputet

Mërgata shqiptare përbën rreth 30% të popullsisë së tërësishme në Kosovë. Deri në përfundim të luftës ajo ishte faktor i rëndësishëm ekonomik dhe politik. Pas përfundimit të luftës ajo vazhdoi ta ruaj rrolin e saj ekonomik. Sot më shumë se 10% e të ardhurave të përgjithshme kombëtare, rreth 600 milion euro në vit, vinë nga mërgata. Fatkeqësisht dhe jo për fajin e sajë, rroli politik i mërgatës është reduktuar në minimum, për të mos thënë është zhdukur fare.

Gjatë zhvillimit të seancës së kaluar, disa portale, mes tyre edhe AL-BINFO publikoi një kërkesë të një varg organizatash, shoqatash dhe institucionesh të mërgimtarëve shqiptar nga Zvicra e Gjermania...

- që përmes Ligjit për Zgjedhje të krijohen mundësi për votim në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës si dhe përmes postës elektronike, pa përjashtuar edhe mundësitë tjera.
- kërkesë e dytë e tyre është që zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë të zhvillohen me 3 gusht kur shumica e qytetarëve nga vendet Perëndimore vinë në Kosovë dhe mund të votojnë drejtë për së drejti.

Ju pyesni, Unia përgjigjet



Zyrtari mjekësor: A duhet të paguaj vet këtë kontroll?

Ka një kohë të gjatë që jam lajmëruar si i sëmurë. Tani shefi im kërkon që të kontrollohem tek zyrtari mjekësor. Me harxhime të mija! A duhet unë në të vërtetë të paguaj vet kontrollin? Dhe a e informon mjeku shefin mbi diagnozën?

Jo. Në parim vlen me sa vijon: Nëse punëdhënësi dyshon në vërtetimin mjekësor të punëmarrësit, atëherë ai mund të kërkojë kontrollimin nga zyrtari mjekësor. Për këtë dyshim ai duhet të ketë pika referuese dëshmuuese. Kjo e drejtë rrjedh nga detyrimi i besnikërisë sipas së drejtës obliguese. Për këtë mendimet janë të ndara në mesimet e drejtësisë. Ka të tilla që thonë se punëdhënësi e ka këtë të drejtë për ta dërguar punëmarrësin për kontroll tek zyrtari mjekësor vetëm nëse kjo është e rregulluar me kontratë. Mirëpo edhe pa një marrëveshje të tillë ne sugjerojmë: pajtohuni të bëni kontrollin zyrtar mjekësor. Pasi, nëse refuzoni, firma mund të ndal pagesën mëtejme të pagës suaj. Harxhimet e kontrollit në të gjitha rastet duhet ti bartë punëdhënësi. Ndërsa për mjekun vlen ruajtja e fshehtësia mjekësore. Ai guxon të informojë punëdhënësin vetëm për atë se në cilën masë është kufizimi i aftësisë punuese për shkaqe shëndetësore (dhe në raport me cilat punë). Zyrtari mjekësor nuk guxon në asnjë rast të jap të dhëna mbi diagnozën dhe sëmundjen. Këto informata mjeku mund ti jap, vetëm nëse pacienti e liron nga ruajtja e fshehtësisë.

Heinrich Nydegger, work, 5.6.2014

Pa sigurim aksidental: A duhet të paguajë sigurimi im shëndetësor?

Unë punoj dy ditë të plota si shitëse në shitoren e fshatit tonë. Javën e kaluar tek ne në shtëpi ishte caktuar pastrimi pranveror. Gjatë pastrimit të dritareve të kuzhinës u rrëzova nga karrigia dhe theva ashtin e këmbës së djathtë. Mjeku shtëpiak më dha tri javë pushim mjekësor dhe më peti për sigurimin tim aksidental. Pasi isha i pasigurt se cili sigurim ishte përgjegjës, pyeta shefin tim. Ky më tha se për aksidentin ishte sigurimi im shëndetësor përgjegjës. Pasi ai kishte punësuar pjesërisht vetëm dy veta, nuk e kishte parë të nevojshme të pajtonte sigurimin aksidental. A ka ai të drejtë?

Jo. Të gjithë punëmarrësit në Zvicër janë detyrimisht të siguruar kundër aksidentit. Aksidentet joprofesionale për të punësuarit e pjesërishtëm janë vetëm atëherë detyrimisht të siguruar, nëse punojnë së paku 8 orë në javë. Për ju pra vlen, që për aksidentin shtëpiak jeni i siguruar detyrimisht. Disa ndërmarrje dhe të punësuarit e tyre (shembulli bie ndërmarrjet industriale, ndërtimore) janë ligjërisht të siguruar tek SUVA (Enti i Sigurimeve Zvicerane të Aksidenteve). Shitorja e fshatit, ku ju keni punuar nuk përfshihet këtu. Këtu punëdhënësi duhet për të punësuarit e vet tek Suva apo ndonjë tjetër sigurim aksidental të lidh një marrëveshje gjegjëse. Punëdhënësi juaj nuk e ka bërë këtë dhe kështu ai ka shkelur detyrimin ligjor. Mirëpo ju nuk keni pasoj nga kjo. Për raste të tilla ligjëdhënësi ka udhëzuar që të krijohet një arkë zëvendësuese. Sigurimet aksidentale paguajnë në këtë arkë një pjesë të të ardhurave nga premitë. Arka zëvendësuese i paguan punëmarrësit e pasiguruar në rast aksidenti përfitimet nga sigurimi. Arka merr nga punëdhënësit përkatës shkelës edhe premitë zëvendësuese. Nëse punëdhënësi edhe përkundër vërejtjes nuk siguron punëmarrësit, nga ana e Arkës atij detyrimisht caktohet një Sigurim Aksidental. Në faqen e internetit www.ersatzkasse.ch mund të lajmëroni online aksidentin e juaj.

Peter Schmid, work, 22.5.2014

Impressum: Beilage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. Garcia, D. Filipovic, E. Sariassian, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck Ringier Print, Adligenswil | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft. Le Syndicat. Il Sindacato.